



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 22.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NPSH Oni Design" për aktivitetin: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" dhe me numër të prokurimit: 616 20 124 121 nxjerr:

### VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "NPSH Oni Design" e datës 21.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" me Nr. 616-20-5025-1-2-1, me Nr. Brendshëm : 616 20 124 121 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ky aktivitet te vazhdohet sipas Njoftimit te dates 16.12.2020.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "NPSH Oni Design" me datë 21.12.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" me numër të prokurimit Nr. 616-20-5025-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616 20 124 121 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet janë të pa bazuara, pasi që tenderet janë valid deri me datën 27.12.2020, sepse të dy tenderuesit i kanë sigurimet e vlefshme deri me atë ditë. Vazhdimi i

vlefshmerise, respektivisht nuk eshte kerkuar pasi qe si rezultat i pandemise zyrtarja qe e administron aktivitetin ka qene ne pushim detyrueshem si rezultat i infektimit.  
Por bazuar ne afatet e sigurimeve ky aktivitet do te vazhdoj dhe do te kerkoet vazhdimi i sigurimeve te tenderit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit